

VENDIM
Nr.511, datë 30.6.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT PËR
TRAJTIMIN E UJËRAVE TË PËRDORURA, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë truall), që preken nga ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të përdorura, Korçë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjetllës–Kanalizime, sh.a., Korçë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 434.5 (katërqind e tridhjetë e katër pikë pesë) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 4 345 000 (katër milionë e treqind e dyzet e pesë mijë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 252 500 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Ujësjetllës – Kanalizime, sh.a., Korçë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 345 000 (katër milionë e treqind e dyzet e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë”, e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.7.2010 dhe të përfundojë më 30.8.2010.
 7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja, Korçë”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Ujësjetllës – Kanalizime, sh.a.-së, Korçë.
 8. Ujësjetllës Kanalizime, sh.a., Korçë, të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet “Konfirmim nga ZRPP-ja, Korçë”, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.
 9. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, në bashkëpunim me Ujësjetllës – Kanalizime, sh.a., Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e sipërfaqes së shpronësuar mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Ujësjetllës–Kanalizime, sh.a., Korçë, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.
 10. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur të realizohen procesi i hedhjes së sipërfaqes së objektit mbi hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.
 11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Ujësjetllës–Kanalizime, sh.a., Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Nr.	Pronari			Nr. i pasurisë	Zona Kadastrës	Lloji i pasurisë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Vasil		Panariti	8/251	8561	Truall	166.2	10000	1 662 000	Konfirmim nga ZRPP Korçë
2	Nikolla	Ligor	Çeço	8/50	8561	Truall	268.3	10000	2 683 000	Konfirmim nga ZRPP Korçë
	Totali lekë								4 345 000	